

**Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit kundër Grave.
Sesioni 28
13-31 Janar 2003**

**Draft report
Raporton: Ms. Christine Kapalata**

Shqipëria

Raporti periodik i parë dhe i dytë i kombinuar.

1- Komiteti mori në konsideratë raportin periodik të parë dhe të dytë të kombinuar të Shqipërisë në takimet e 594, 595 dhe 605, në 16 dhe 24 Janar 2003.

A) Parathënie nga pala shtetërore.

2- Në paraqitjen e raportit të parë dhe të dytë të kombinuar, përfaqësuesja e Shqipërisë u shfajësua për vonesën në dorëzimin e këtij raporti, por theksoi se përgatitja e këtij raporti e kishte ndihmuar Qeverinë në analizimin e gjendjes së grave në Shqipëri duke iu referuar kushteve të Konventës, në formulimin e programeve të reja dhe rishikimin e politikave ekzistuese. Në përshkrimin e situatës të zbatimit të konventës në vendin e saj, përfaqësuesja tha se pabarazitë gjinore janë shtuar në Shqipëri, si rrjedhojë e tranzicionit të vendit në ekonominë e tregut në 1991. Megjithëse burrat dhe gratë kishin të drejta të barabarta në Shqipëri dhe gratë kishin një nivel të lartë të edukimit, nuk ekzistonte një akses i barabartë në burime, mundësi ose përfitime. Përfaqësuesja paraqiti punën e bërë deri më tani që ka kontribuar në ndërtimin e ndërgjegjësimit të barazisë gjinore dhe një partneritet të barabartë midis Shtetit dhe lëvizjes së grave në Shqipëri, roli i së cilës ka qenë shumë i rëndësishëm në përparimin e grave në vend.

3- Përfaqësuesja theksoi se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në 1998, konsolidoi të drejtat kryesore dhe liritë e qenieve njerëzore, në përputhje me instrumentat ligjore ndërkombëtare, që garantonin të drejta të barabarta për burrat dhe gratë. Sipas Nenit 18 të Kushtetutës, diskriminimi i bazuar në seksin, besimin fetar apo origjinën etnike u ndalua. Ndërsa aderimi në Konventë në 1993 shënoi pikën e fillimit për integrimin e standarteve ligjore ndërkombëtare në ligjin e brendshëm, praktika aktuale nuk ofronte mekanizma që mund të siguronin që gratë të kishin të drejta të barabarta me burrat.

- 4- Përfaqësuesja tregoi se Komiteti i Shtetit për Gruan dhe Familjen, së fundmi i quajtur: Komiteti për Mundësi të Barabarta, u themelua në 1998 me qëllim që të siguronte ndihmë institucionale për përkrahjen e interesave të grave, ndër të tjera zbatimin e politikave qeveritare për çështjet e grave dhe të familjes, duke koordinuar dhe vlerësuar programet, duke projektuar propozime për legjislacion të ri dhe/ose amendamente për legjislacionin ekzistues për familjen dhe të drejtat e grave në përputhje me standartet ndërkombëtare, duke mbështetur aktivitetet e OJQ-ve për gratë dhe familjen.
- 5- Përfaqësuesja shtoi se Komiteti Shtetëror për Mundësi të Barabarta, si instrument kryesor për nxitjen e avancimit të grave brenda Qeverisë, i koordinoi këto përpjekje jo vetëm me ministritë sektoriale, strukturat administrative, qeverisjen lokale dhe OJQ-të, por gjithashtu edhe me organizatat ndërkombëtare.
- 6- Përfaqësuesja theksoi se pavarësisht nga përpjekjet e bëra nga qeveria deri më tani, mbeten ende shumë pengesa, veçanërisht pjesëmarrja e pakët i grave në strukturat qeverisëse, të cilat kufizonin kontributin e tyre në dhënien formë dhe menaxhimin e zhvillimit demokratik të vendit. Në fakt, gjatë procesit të përshtatjes strukturore, gratë, si të punësuarat kryesore në sektorin social, humbën vende pune më shumë se burrat, duke e çuar nivelin e papunësisë të grave deri në 20% krahasuar me nivelin e papunësisë për burrat prej rreth 14%.
- 7- Përfaqësuesja shtoi se duke u mbështetur tek fakti që pjesa më e madhe e burrave nuk kanë marrë pjesë totalisht në përgjegjësitë familjare, mbyllja e çerdheve dhe kopshteve dhe ndalimi i shërbimeve të tjera mbështetëse sociale ka ushtruar një ngarkesë të dyfishtë në kohën e grave, gjë që kufizoi mundësitë e tyre për të luftuar për ushtrimin e të drejtave të tyre.
- 8- Platforma Kombëtare për Përparimin e Grave në Shqipëri, e zbatuar nga Shteti në bashkëpunim me OJQ-të e grave dhe kontributin e komunitetit donator si një instrument për zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit, ka kontribuar deri më tani në përparimin e pjesëmarrjes së grave në marrjen e vendimeve, në krijimin e programeve mikro-financiare për gratë nga zonat rurale, mbështetjen për aktivitete që kanë të bëjnë me lidhjet gjinore dhe ndërgjegjësimin për të drejtat e grave në vend.
- 9- Sfida të caktuara mbeten në realizimin e zbatimit efektiv dhe mekanizmave monitorues që do të mund të siguronin planifikim strategjik, financim të mjaftueshëm për aktivitetet e Platformës së Pekinit për Veprim dhe influencë tek qëndrimet sociale që pengonin përparimin e grave.

10-Midis tendencave ekzistuese positive, përfaqësuesja theksoi përsëritjen e teksteve që përfshijnë një perspektivë gjinore, përpjekjet e bëra për të themeluar një institut gjinor brenda Fakultetit të Sociologjisë në Universitetin e Tiranës, ndërgjegjësimin mes partive politike për nevojën për të rritur pjesëmarrjen e grave në marrjen e vendimeve, duke përfshirë prezantimin e një sistemi kuotash në ligjin elektorale dhe rëndësinë e një rrjedhe të përgjithshme kryesore gjinore si një strategji e re për të arritur barazinë gjinore.

11-Si përfundim, përfaqësuesja e Shqipërisë tregoi se përveç përpjekjeve të bëra për zbatimin e Konventës, Qeveria ishte e ndërgjegjshme për faktin se shumë më tepër duhej bërë për të rritur dhe përparuar gëzimin e të drejtave të grave në praktikë. Kështu, Qeveria e Shqipërisë u angazhua për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit si një guidë e përdorshme drejt programeve më të shumta dhe më të mira për përparimin e grave në Shqipëri.

b- Komentet përfundimtare të Komitetit.

Parathënie

12-Komiteti lavdëron palën e Qeverisë për raportin periodik, i cili, megjithëse i vonuar përputhet me udhëzimet e Komisionit për përgatitjen e raporteve fillestare.

13-Komiteti lavdëron palën e Qeverisë për delegacionin, i cili u kryesua nga Kryetarja e Komitetit për Mundësi të Barabarta, dhe shpreh përgëzime për prezantimin e hapur dhe të sqartë nga delegacioni, i cili siguroi informacion shtesë mbi situatën aktuale të Zbatimit të Konventës në Shqipëri, dhe përgjigjet e dhëna ndaj pyetjeve gojore të bëra nga anëtarët e Komitetit.

14-Komiteti vuri re me kënaqësi se veprimtaria e Qeverisë për të zbatuar Konventën, duke përfshirë edhe Platformën Kombëtare për Përparimin e Grave, është vendosur brenda kontekstit të zbatimit të Platformës të Pekinit për Veprim dhe dokumentit të dalë nga sesi i 23-të special i Asamblesë së Përgjithshme, i titulluar: “Gratë 2000, Barazi gjinore, zhvillim dhe paqe për shekullin e 21”

Aspektet pozitive

15-Komiteti mirëpret faktin se Shqipëria ratifikoi Konventën në 1994 pa rezerva. Komiteti lavdëroi përpjekjet e palës së Qeverisë për përkthimin e konventës në shqip dhe propagandimin e saj.

16-Komiteti mirëpret krijimin e shpejtë të një mekanizmi për përparimin e grave dhe të drejtave gjinore dhe krijimin e Zyrës të Avokatit të Popullit, i cili mund

- të hetojë pretendime të dhunimit të të drejtave të qenieve njerëzore, duke përfshirë edhe të drejtat e grave dhe për të bërë rekomandime për kompensimin e dëmshpërblimin për rastet e dhunës.
- 17-Komiteti mirëpret përpjekjet e ndërmarra nga pala qeveritare për përmirësimin e të dhënave dhe statistikave për gratë, krijimin e Qendrës së Informacionit dhe Dokumentacionit, si dhe bashkëpunimin e tij me Institutin Kombëtar të Statistikave. Gjithashtu mirëpret vendimin e zbatimin e programeve specifike të punësimit për gratë në gjysmën e dytë të 2003.

Sferat kryesore të shqetësimeve dhe rekomandimeve.

- 18-Duke vënë re me kënaqësi, se në parim, Konventa është përfshirë në ligjin shqiptar dhe kështu ka precedencë mbi ligjet kombëtare të cilat bien në kundërshtim me ato klauzola të Konventës të cilat mendohet të jenë direkt të praktikueshme. Komiteti është megjithatë i prokupuar rreth mungesës së qartësisë që ka të bëjë me aplikimin e drejtpërdrejtë të Konventës në Shqipëri.
- 19-Komiteti i bën thirrje Qeverisë të sqarojë çështjen e aplikimit direkt të Konventës brenda kuadrit ligjor kombëtar të Shqipërisë.
- 20-Duke parë se Kushtetuta dhe një numër ligjesh ndalojnë diskriminimin gjinor, Komiteti shpreh shqetësimin se pala qeveritare nuk ka ndërmarrë një rishikim të ligjeve për të siguruar konformitetet me Konventën dhe se disa klauzola që diskriminojnë gratë mund të vazhdojnë të ekzistojnë.
- 21-Komiteti i bën thirrje palës shtetërore të rishikojë të gjitha ligjet ekzistuese dhe të përmirësojnë klauzolat e ngelura diskriminuese që të bëhen të krahasueshme me rekomandimet e përgjithëshme të Konventës dhe Komiteti. Ajo inkurajon miratimin e shpejtë të Kodit të Familjes nën rishikim, duke përfshirë klauzolën e barazisë midis burrave dhe grave në moshën minimale të martesës.
- 22-Komiteti është i preokupuar se gratë kanë përdorur rrallë ligjet ekzistuese për të sfiduar aktet e diskriminimit dhe se nuk ekziston një evidentim i vendimeve gjyqësore në të cilat mund të ishte dashur të rishqyrtohej rreth rasteve të tilla.
- 23-Komiteti i bën thirrje palës shtetërore të sigurojë se ligji shqiptar ofron procedura përforcuese adekuate, të hapura, dhe të përballueshme dhe mjete ligjore për dhunimin e të drejtave të grave. Komiteti fton palën shtetërore të japë në raportin e saj të ardhshëm, informacion rreth ankesave të arkivuara në gjykata mbi bazën e Konventës, si dhe ndonjë lloj vendimi të gjyqit që i referohet Konventës.
- 24-Komiteti është i shqetësuar se ekziston një mungesë e familiaritetit me Konventën dhe mundësitë për aplikimin dhe forcimin e saj, duke përfshirë

- edhe personelin që merret me aplikimin e ligjit dhe organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut dhe të grave.
- 25- Komiteti rekomandon paraqitjen e programeve të edukimit dhe trajnimit rreth Konventës, në veçanti për parlamentarët dhe personelin juridik dhe ligjor. Ai rekomandon të ndërmerret një fushatë e rritjes së ndërgjegjësimit, që ka të bëjë kryesisht me gratë, që ato të përfitojnë nga procedurat dhe mundësitë që kanë për ankim në rast të dhunimit të drejtave të tyre, të parashikuara në Konventë.
- 26- Duke mirëpritur përpjekjet e Komitetit për Mundësi të Barabarta, Komiteti shpreh shqetësimin e tij se mekanizmi kombëtar për përparimin e grave nuk ka një qartësi të mjaftueshme, fuqi ose burime njerëzore dhe financiare për të arritur në mënyrë efektive përparimin e grave dhe barazinë gjinore.
- 27- Komiteti rekomandon që pala shtetërore të forcojë mekanizmin ekzistues kombëtar me qëllim që ta bëjë atë më efektiv duke e pajisur me transparencë të mjaftueshme, burime njerëzore dhe financiare në të gjitha nivelet duke rritur bashkëpunimin midis mekanizmave ekzistues në nivel lokal dhe kombëtar për përparimin e të drejtave të grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Gjithashtu rekomandon që drejtimi gjinor në të gjitha ministritë, politikat dhe programet, të forcohet përmes trajnimit gjinor dhe krijimit të pikave fokale.
- 28- Komiteti është i shqetësuar për vazhdimësinë e stereotipeve të ngulitura e të trashëguara rreth rolit dhe përgjegjësive të grave dhe burrave në familje dhe në përgjithësi në shoqëri. Komiteti gjithashtu është i shqetësuar për gjallërimin e kanunit dhe të kodeve tradicionale të sjelljes në disa zona të Veriut të vendit.
- 29- Komiteti i bën thirrje palës shtetërore të marrë masa për eliminimin e praktikimit të kanunit dhe të kodeve tradicionale të sjelljes që diskriminojnë gruan. Komiteti gjithashtu i bën thirrje palës shtetërore të përpilojë dhe zbatojë programe të kuptueshme në sistemin edukativ për të siguruar çrrënjosjen e stereotipeve tradicionale lidhur me ndarjen gjinore në familje, në punë, politikë dhe shoqëri. Komiteti rekomandon që pala shtetërore të inkurajojë masmedian për të nxitur ndryshime kulturore lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e burrave dhe grave, siç kërkohet edhe në nenin 5 të Konventës.
- 30- Duke njohur përpjekjet e bëra nga pala shtetërore për adresimin e çështjes së trafikimit të grave dhe vajzave, duke përfshirë ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollit të tij për ndalimin dhe ndërkimimin e trafikimit të njerëzve, kryesisht të grave dhe fëmijëve, Komiteti mbetet i shqetësuar për vazhdimësinë e mbizotërimit të këtij problemi në Shqipëri, i cili është kthyer në një vend origjine dhe tranziti për gratë dhe vajzat e trafikuar. Është e shqetësuar sepse viktimat e trafikimit janë subjekt ndërshkimi në Kodin Penal

të Shqipërisë. Është e shqetësuar se prostitutat, por jo ata që shfrytëzojnë prostitutat, ndiqen dhe ndërshkohen.

- 31- Komiteti rekomandon formulimin e një strategjie të kuptueshme për të luftuar trafikimin e grave dhe vajzave, i cili do të përfshijë edhe ndalimin dhe ndjekjen e shkelësve. Komiteti gjithashtu inkurajon palën shtetërore të vazhdojë bashkëpunimin më të madh ndërkombëtar, dypalësh dhe rajonal me vendet e tjera të origjinës, tranzitit, dhe destinacionit të trafikimit të grave dhe vajzave. Ai gjithashtu rekomandon përdorimin e masave që synojnë përmirësimin e situatës ekonomike të grave, në mënyrë që të eliminojnë dobësitë e tyre ndaj trafikantëve, iniciativa arsimore për grupet e dobëta që përfshijnë adoleshentët, dhe ndihmë sociale, masa rehabilituese dhe riintegruese për gratë dhe vajzat që kanë qenë viktimat të trafikimit. Ajo i bën thirrje palës shtetërore të sigurojë që gratë dhe vajzat e trafikuar të kenë mbrojtjen dhe mbështetjen që nevojitet për të bërë të mundur sigurimin e dëshmisë kundër trafikantëve. Ajo gjithashtu bën thirrje që trajnimi i policisë së kufirit të sigurojë pajisjen e tyre me aftësitë e domosdoshme për të njohur dhe ditur si të veprojnë për të ofruar ndihmë tek viktimat e trafikimit. Kërkon gjithashtu edhe që pala qeveritare të rishikojë legjislacionin aktual dhe të sigurojë që viktimat e trafikimit të mos ndiqen penalisht dhe se gjithë ata që shfrytëzojnë prostitutat të ndiqen dhe ndërshkohen. Më tej Komiteti bën thirrje që pala shtetërore ta konsiderojë çështjen e trafikimit të grave dhe vajzave, një nga prioritetet e saj kryesore dhe të përfshijë në raportin e saj të ardhshëm gjithë informacionin dhe të dhënat përkatëse dhe progresin e bërë në këtë drejtim.
- 32- Komiteti shpreh shqetësim rreth shkallëzimit të dhunës kundër grave, duke përfshirë edhe dhunën në familje. Komiteti është i shqetësuar se Kodi Civil Shqiptar nuk bën dallim mes akteve të kryera nga persona të tjerë dhe akteve të kryera nga një anëtar i familjes dhe se asnjë akt specifik ligjor nuk është miratuar për të luftuar dhunën në familje. Është e shqetësuar se ekziston një mungesë në grumbullimin sistematik të të dhënave statistikore për dhunën kundër grave, kryesisht dhunën në familje.
- 33- Në kuadrin e rekomandimit të përgjithshëm 19, Komiteti i bën thirrje palës shtetërore t'i japë prioritet të lartë masave që i adresohen dhunës kundër grave në familje dhe në shoqëri dhe të njohë se dhuna të tilla, duke përfshirë edhe dhunën në familje përbëjnë një dhunim të të drejtave të grave sipas Konventës. Komiteti i bën thirrje palës qeveritare të miratojë legjislacionin e duhur për dhunën në familje dhe të sigurojë që dhuna kundër grave të ndiqet dhe ndërshkohet me seriozitetin dhe shpejtësinë e duhur. Gratë, viktimat të dhunës duhet të sigurohen me mjete të menjëhershme për dëmshpërblim dhe mbrojtje, duke përfshirë edhe akses për ndihmë ligjore. Komiteti rekomandon që masat të ndërmerren për të siguruar strehë për gratë viktimat të dhunës dhe të sigurojë që autoritetet publike, në veçanti organet e rendit, gjyqësori organet

- shëndetësore dhe punonjësit socialë të sensibilizohen për të gjitha format e dhunës kundër grave. Komiteti rekomandon që pala shtetërore të krijojë një strukturë për mbledhjen sistematike të të dhënave rreth dhunës kundër grave, përfshirë këtu edhe dhunën familjare. Komiteti fton palën shtetërore të ndërmarrë masa për rritjen e ndërgjegjësimit, përmes medias dhe programeve publike të edukimit që ta bëjë këtë lloj dhune të papranueshme në nivelin shoqëror dhe moral.
- 34- Komiteti është i shqetësuar nga shkalla më e lartë e papunësisë të grave sesa të burrave. Komiteti është i shqetësuar që gratë nuk janë në gjendje të marrin trajnim dhe ritrajnim të mjaftueshëm për të konkuruar në tregun e punës. Komiteti është i shqetësuar rreth diskriminimit në pranimin në punë të grave, kryesisht në sektorin privat.
- 35- Komiteti i bën thirrje palës shtetërore të sigurojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në tregun e punës, midis të tjerash, marrjen e masave të veçanta të përkohshme në përputhje me nenin 4, paragrafi 1 i Konventës. Komiteti rekomandon që pala shtetërore të përpilojë dhe të zbatojë programe speciale trajnimi dhe ritrajnimi për grupe të ndryshme të grave të papunësuara. Ai gjithashtu rekomandon masa efektive që lejojnë pajtimi i përgjegjësive familjare dhe profesionale të forcohet dhe të sigurohet ndarja e përgjegjësive të brendshme dhe familjare mes burrave dhe grave. Komiteti kërkon që pala shtetërore të japë në raportin e ardhshëm më shumë informacion të detajuar për situatën e grave në tregun e punës, duke përfshirë punët e grave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, nivelin e tyre dhe pagat e tyre.
- 36- Komiteti është i shqetësuar rreth situatës për gratë e zonave rurale, që përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë femërore, që janë të diskriminuara përse i përket zotërimit dhe trashëgimit të pasurisë, dhe që janë në disavantazh nga varfëria, infrastruktura e varfër, mungesa e kreditimit dhe një akses të kufizuar në arsimim, shërbime shëndetësore dhe sigurime shoqërore. Duke vënë re numrin e vajzave që lënë shkollën, Komiteti është i shqetësuar për këtë problem të vazhdueshëm. Komiteti është gjithashtu i shqetësuar për gratë e zonave rurale që përfaqësohen rrallë në organet e qeverisjes lokale.
- 37- Komiteti bën thirrje që pala shtetërore t'i kushtojë vëmendje të plotë nevojave të grave nga zonat rurale dhe të zhvillojë politika dhe programe, që synojnë forcimin e tyre ekonomik, duke ju siguruar atyre akses në burimet prodhuese, kapitalit dhe kreditit, ashtu si edhe në arsimim, shërbime mjekësore, sigurimet shoqërore dhe në marrjen e vendimeve. Komiteti i kërkon palës shtetërore të ndërmarrë një studim mbi pronësinë dhe trashëgiminë e tokës nga gratë rurale dhe të situatës së tyre të përgjithshme ekonomike, arsimore dhe sociale dhe të raportojë rezultatet në raportin e ardhshëm periodik.

- 38- Ndërsa mirëpret përdorimin e kuotave minimale të kandidateve femra nga disa parti politike në zgjedhjet lokale, Komiteti është i shqetësuar për përfaqësimin e ulët të grave në nivelet e larta të zgjedhura dhe emëruara, si psh, anëtarë parlamenti, zyrtarë të larta brenda organeve ekzekutive të Qeverisë, të gjyqësorit, shërbimit civil dhe diplomatik, si dhe në kuadër të qeverisjes lokale.
- 39- Komiteti i bën thirrje palës qeveritare të marrë masa që përfshijnë përmirësime në ligjin elektoral, rritjen e përfaqësimin të grave në organet e zgjedhura apo të emëruar nëpërmjet zbatimit të masave të përkohshme specifike, në përputhje me nenin 4, paragrafi 1 të Konventës, me qëllim që të realizojë të drejtat e grave për t'u përfshirë në të gjitha fushat e jetës publike, veçanërisht në nivelet e larta të vendimmarrjes. Komiteti rekomandon që pala shtetërore të risë përpjekjet në drejtim të sigurimit apo mbështetjes së programeve të trajnimit për gratë lidere aktuale dhe të së ardhmes dhe të kryejë fushata të ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në marrjen e vendimeve politike.
- 40- Duke mirëpritur bashkëpunimin e palës shtetërore me organizatat jo-qeveritare që merren me çështjet e të drejtave të grave dhe me njohjen e rolit të rëndësishëm të tyre, Komiteti vë re me shqetësim kapacitetin dhe burimet e pamjaftueshme të këtyre organizatave, që e bën të vështirë për to zbatimin e projekteve dhe programeve të tyre në mbrojtje të të drejtave të grave. Komiteti është gjithashtu i shqetësuar se pala shtetërore i kalon përgjegjësitë e saj për mbrojtjen dhe plotësimin e të drejtave të grave tek organizatat jo-qeveritare dhe donatorët ndërkombëtare.
- 41- Komiteti rekomandon që pala shtetërore të forcojë mbështetjen për punën e organizatave jo-qeveritare dhe të sigurojë që detyrimet e tij sipas Konventës të integrohen plotësisht në përgjegjësitë e përgjithshme qeveritare dhe që ato të mos kryhen vetëm nga shoqatat jo-qeveritare.
- 42- Komiteti i bën thirrje palës shtetërore që të pranojë ndryshimin e nenit 20, paragrafi 1, të Konventës, lidhur me kohën e takimit të Komitetit.
- 43- Komiteti inkurajon palën shtetërore të ratifikojë Protokollin Opsional të Konventës.
- 44- Duke marrë parasysh dimensionet gjinore të deklaratave, programeve, dhe platformave për veprim të miratuara nga konferencat përkatëse të Kombeve të Bashkuara, samiteve, sesioneve speciale (siç janë sesioni special i Asamblesë së Përgjithshme për të rishikuar dhe vlerësuar zbatimin e Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (sesioni 21-të special), sesioni special i Asamblesë së Përgjithshme për fëmijët (sesioni 27-të

special), Konferenca Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit, Ksenofobisë dhe Asambleja e dytë Botërore mbi Plakjen), Komiteti i kërkon palës shtetërore që në raportin periodik të ardhshëm të përfshijë informacion për zbatimin e aspekteve të këtyre dokumentave, që kanë të bëjnë me nenet përkatëse të Konventës.

45- Komiteti i kërkon palës shtetërore t'i përgjigjet shqetësimeve të shprehura në komentet përfundimtare në raportin e ardhshëm periodik që do të dorëzohet në bazë të nenit 18 të Konventës. Ai gjithashtu kërkon që raporti t'i referohet rekomandimeve të përgjithshme të Komitetit dhe të sigurojë informacion rreth ndikimit të legjislacionit, politikave dhe programeve të hartuara për zbatimin e Konventës.

46- Komiteti kërkon që komentet e tanishme përmbyllëse të përhapen gjerësisht në Shqipëri, me qëllim që të bëhet më i ndërgjegjshëm populli shqiptar, e në veçanti zyrtarët qeveritarë dhe politikanët mbi hapat që janë ndërmarrë për të siguruar *de juro* dhe *de facto* barazinë e grave dhe hapat e mëtejshme në këtë aspekt. Ai gjithashtu kërkon që pala shtetërore të vazhdojë të përhapë gjerësisht, në veçanti për organizatat e grave dhe ato të drejtave të njeriut Konventën CEDAW, Protokollin e saj Opsional, rekomandimet e përgjithshme të Komitetit dhe Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim, si dhe rezultatet e sesionit special të 23-të të Asamblesë së Përgjithshme të titulluar: "Gratë 2000: Barazi gjinore, zhvillim dhe paqe për shekullin e 21-të".